

VENDIM
Nr. 52, datë 20.12.2024

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
KORÇË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958); si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 20.12.2024, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a.”,

KONSTATON SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a., me shkresën nr. 931 prot., datë 25.11.2024, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. (NUIS M24431001N) është themeluar më datë 12.7.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51% dhe Bashkitë Korçë me 28.29%, Kolonjë me 3.64%, Devoll me 7.76%, Maliq me 8.67%, Pustec me 0.63%;

b) Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 169 932 banorë të bashkive Korçë, Kolonjë, Devoll, Maliq, Pustec;

c) Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a. ofron shërbimin trajtimit të ujërave të ndotura për 63 736 banorë të Bashkisë Korçë;

d) Drejtues teknik i shoqërisë z. Pandi Qirinxhi është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së ndërtimit, dega Gjeodezi në vitin 1985 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

e) Drejtues teknik i shoqërisë për impiantin e përpunimit të ujërave të ndotura z. Aleks Andoni është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në degën Kimi industriale në vitin 1993 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a., të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të

mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Korçë sh.a. me (NUIS M24431001N), në kategoritë:

- a) Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura;
- c) Kategoria D: Për trajtimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Korçë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues ligjor: Petrit Tare;
- b) Drejtues teknik: Pandi Qirinxhi;
- c) Drejtues teknik: Aleks Andoni.

3. Zona e shërbimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Korçë sh.a. janë bashkitë Korçë, Kolonjë, Devoll, Maliq, Pustec.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Korçë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Korçë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE

Evis Shurdha